Kronikë

Atentat i dështuar në Bushat të Vaut të Dejës! Qëllohet me breshëri kallashnikovi ndaj 'Audit' të blinduar, në kërkim vëllezërit Prendi e një tjetër

Dy personave të cilët policia i ka identifikuar por nuk i zbulon publikisht emrat, iu bë atentat në Bushat nga 3 persona të shpallur në kërkim. 'Audi' i blinduar në të cilën udhëtonin u qëllua me breshëri kallashnikovi. Gjurmë plumbash edhe në makinën tjetër.

■ VIDEO/ Vendi ku ndodhi përplasja në Shkodër

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Ergys Kavaja
24 Gusht, 11:29 | **Përditësimi: 24 Gusht, 15:31**

Share

A A

Shkodër - Dy personave, të cilëve policia e Shkodrës nuk ia zbulon emrat për shkak të hetimeve, iu bë atentat mbrëmjen e së premtes (23 gusht 2024) në fshatin Ranxë të Bushatit.

Ty dy, ndodheshin brenda një automjeti të blinduar, Audi me targa gjermane, kur ndaj tyre u lëshua ***breshëri kallashnikovi***. Zyrtarisht policia shprehet e rezervuar në informacione, por burimet thonë se autorët, tashmë të identifikuar, kanë qëlluar në ecje nga një motor dhe me një automjet BMV.

Zyrtarisht sipas bluve të Shkodrës, 3 janë autorët që kanë qëlluar, por nuk jep emrat e tyre, edhe pse jo zyrtarisht flitet për 2 vëllezër me mbiemrin Prendi nga fshati Ranxë ku ndodhi atentati, dhe një person i tretë.

LEXO EDHE:
Shkodër/ Asgjësohen 361 bimë kanabis, vihet në pranga 67-vjeçari! Ja momenti kur kapet në flagrancë (VIDEO)

Burime të pakonfirmuara thonë se hetuesit kanë gjetur edhe automjetin e autorëve, i cili jo zyrtarisht thuhet se ka gjurmë plumbash, çka mund të lë hapësirë se mes palëve ka pasur shkëmbim zjarri.

Dyshja brenda automjeti të blinduar nuk ka pësuar asnjë lëndim, të cilët policia i ka identifikuar, por nuk i përmend as si persona në kërkim as të ndaluar, çka lë dyshime që edhe ata të kenë braktisur në rrugë Audi-n, e të jenë larguar, me një tjetër automjet që dyshohet se e kishin për mbështetje.

Burime jo zyrtare thonë personat me Audi po shkonin tek vëllezërit Prendi për një konflikt të dyshuar mes tyre, por janë pritur me armë zjarri.

Të dyshuarit akuzohen për "Vrasja me paramendim" e mbetur në tentative kryer në bashkëpunim dhe armëmbajtje pa leje.

M.Q./E.H/Shqiptarja.com

TAG: Shkodër | vau i dejes | te shtena me arme | bushat | Ranxë

Komento

Komente

Uka: 24/08/2024 14:06

Fshatarve te shkret ju nxjerrni emrat , bajreve jo ! Hajde polici hajde

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Anti-berishistët mbledhin firmat për partinë e re, a do të mbështetet?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Bushat/ Qëllohet me armë drejt një 'Audi', dyshohet se ka pasur shkëmbim zjarri nga dy makina! Gjenden 10 gëzhoja! S'ka të lënduar
23 Gusht, 20:08

FOTOT/ Ja si do të duket zona e Zdrales në Shkodër pas transformimit! Tenderi 275 milionë lekë, pritet nisja e punimeve
23 Gusht, 12:52

Operacioni antikanabis vijon në Malësi të Madhe e Shkodër, në total asgjësohen 1800 fidanë
23 Gusht, 10:37

Vrasja e dyfishtë në Velipojë, Gjykata lë në qeli dy punëtorët e arrestuar, në arrati 2 vëllezërit pronarë të hotel 'Holiday'! Kamerieri: E pashë kush qëlloi
22 Gusht, 14:36

Shoku vdiq në Velipojë, Italiani: U përplasëm me Jet-Ski, por ai ra në det nga dallga! 50 ditë burg për 20-vjeçarin
Ergys Kavaja
22 Gusht, 13:36

Shkodër/ Çelet tek 'Marubi' ekspozita e rallë 'Vëllezërit Kodheli dhe Kolë Idromeno, Rilindja në Artin Pamor Shqiptar'
Ergys Kavaja
21 Gusht, 16:52

Malësia e Madhe 'luftë' si Lazarati, trafikantët e drogës qëllojnë në ajër sa shohin efektivët dhe arratisen! RENEA dhe FNSH rrethojnë zonën (VIDEO)
21 Gusht, 12:33

Asgjësohen 4 parcela me 2848 bimë kanabisi në Shkodër! Në kërkim 48-vjeçari
21 Gusht, 11:10

U kapën me 332 kg kanabis dhe kultivuan 32 mijë rrënjë narkotike në 2022, SPAK dërgon për gjykim grupin kriminal prej 23 personash në Malësi të Madhe
21 Gusht, 09:37

Malësi e Madhe/ Kultivuan kanabis në fshatin Selcë, vihen dy persona në pranga (EMRI)
20 Gusht, 13:56

Shkodër/ Tre të rinj në pranga, shpërndanin doza kanabisi në qytet
20 Gusht, 12:37



Vrasja e dyfishtë në Velipojë/ Në arrati vëllezërit Frroku, pronarë të hotel 'Holiday', arrestohen 2 punonjësit! Viktimat ishin kunetër me njëri-tjetrin (EMRAT)
Ergys Kavaja
20 Gusht, 10:20

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje